

Nr. Prot. 3037 /

Tiranë, më 24/4 / 2023

**Lënda: Miratim Lidhje Impiant Fotovoltaik Vetëprodhues**

**Drejtuar: MC Donalds**

**Për Dijeni: Z. Irland Sina  
Drejtor i Drejtorisë Rajonale Elbasan**

I nderuar,

Referuar kërkesës së MC Donalds për lidhje te impiantit fotovoltaik Vetëprodhues të ofruar me fuqi te instaluar të impjantit P=227 kW, kontrata nr EL0A260122303853 miratojmë:

- Impianti Fotovoltaik do te implementohet me rrjetin e shperndarjes në pikën aktuale të lidhjes Kabina: MC DONALDS, fideri 6, nënstationi KUSARTH\_110/20KV
- Të gjitha investimet për lidhjen e impiantit do të kryhen nga investitori.
- Vendosja e paisjeve nën tension do të realizohet vetëm pasi të jetë zbatuar rregullorja e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik të paisjeve nën tension
- Subjekti është i detyruar, sipas nenit 15 "Skemat e matjes neto të energjisë, të ligjit Nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë", të instalojë me shpenzimet e veta një matës inteligjent me dy drejtime, sipas kërkesave të përcaktuara nga OSSH në përputhje me Kodin e Matjes. Matësi, duhet të matë energjinë elektrike që subjekti merr nga rrjeti i OSSH dhe energjinë elektrike që subjekti (impianti PV) fut në rrjetin e OSSH. Për të njohur konsumin e përgjithshëm të energjisë elektrike të klientit vetëprodhues, vendoset një matës inteligjent me një drejtim të prodhimit pas inverterit kryesor, sipas kërkesave të përcaktuara nga OSSH në përputhje me Kodin e Matjes.
- Klienti nuk do të ndërhyjë apo lejojë ndonjë interferencë tek Pajisjet e Matjes dhe do të dëmshpërblejë OSSH sh.a në rast të ndonjë ndërhyrjeje.
- Fuqia e instaluar e impiantit fotovoltaik për prodhimin energjise elektrike nga dielli për cdo pikë lidhje ose konsumator do të përlllogaritet në bazë të orëve të punës në pik të prodhimit të energjisë elektrike nga ky impiant po asnjëherë nuk duhet te kaloje fuqine e kerkuar te kontrates ekzistuese me OSSH sha.

- OSSH ka të drejtë të shkëpusë impiantin fotovoltaik për vetëkonsum në rast kur vërteton se klienti ka projektuar një impiant i cili në harkun e një viti tejkalon konsumin e energjisë elektrike të klientit ose kur vërtetohet se impianti është instaluar dhe/ose funksionon ndryshe nga projekti i miratuar.

Pas miratimit të rregullave teknike procedurave , tarifave dhe propozimeve për ndryshim të Kodit të Shpërndarjes dhe Kodit të matjes nga ERE si detyrime që përcaktohen në udhëzimin e MIE nr.3 date 20.06.2019, ky miratim do të jetë subjekt i rishikimit sipas kritereve të miratuara për impiantet PV për vetëprodhim sipas skemës së matjes neto.

Deri në miratimin e Metodologjisë së miratuar nga Këshilli i Ministrave, teprica e energjisë, më e madhe se konsumi mujor do t'i shitet furnizuesit të shërbimit universal me çmim 0 (zero).

Baza Ligjore e Akt-Marrëveshjes

Përpara fillimit të punimeve investitori duhet të ketë plotësuar dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave të përcaktuara në “Udhëzimin nr 3 te MIE dt 20.06.2019” .

Me konsideratë,

**Blendian DALIPI**  
Administrator

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A**

Nr. Prot 3037/  
2

Tiranë më 27 / 4 / 2023

## MARRËVESHJE E LIDHJES SË VETEPRODHUESIT E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA DIELLI

Midis palëve :

Aplikanti

- **MC Donalds**
  
  
- **Operatori i Sistemit Të Shpërndarjes OSSH sh.a**  
**Blendian DALIPI**

## AKT - MARRËVESHJE

Kjo marrëveshje lidhet më datë: \_\_\_ / \_\_\_ / 2023

### NDËRMJET:

- (1) **Operatorit i Sistemit Te Shperndarjes OSSH sh.a**, me seli qendrore në adresën: : Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.I, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me nr.nipt L81530018E.
- (2) **MC Donalds** me vend të ushtrimit të aktivitetit në adresën [Elbasan ] - (këtu e më poshtë referuar me termin Klienti).

### KU:

Klienti ka aplikuar në OSSH dhe OSSH ka rënë dakord për , lidhjen e vetëprodhuesit të energjisë elektrike nga dielli me rrjetin e shpërndarjes, që është pjesë e afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

### Është rënë dakord si më poshtë:

#### 1. Objekti i Akt-Marreveshjes

Kjo Akt - Marreveshje ka për objekt , lidhjen e vetëprodhuesit të energjisë elektrike nga dielli me rrjetin e shpërndarjes me adresë Elbasan me kërkesë të investitorit MC Donalds. Investitori do të vendosë në dispozicion në shërbim të OSSH sh.a me qëllim që kjo e fundit të kryejë studimet dhe vlerësimet e saj në drejtim të interesave studimore dhe vlerësuese të shoqërisë së saj për nxjerrjen e konkluzioneve për këtë kategori impiantesh që lidhen me rrjetin .

- nga pikëpamja e efikasitetit të energjisë;
  - nga pikëpamja e prodhimit të energjisë elektrike nga dielli;
  - nga pikëpamja e arritjes së objektivave të vetëkonsumit.
  - nga pikëpamja e ndikimit në parametrat e rrjetit shpërndarës.
  - nga pikëpamja e sigurisë së operimit
  - nga pikëpamja e protokolleve të mbrojtjes
  - etj
- 
- Impianti Fotovoltaik Vetëprodhues i “MC Donalds” do të lidhet me rrjetin e shpërndarjes në pikën aktuale të lidhjes kabina [MC DONALDS],

fideri [6], ], Nenstacioni[ KUSARTH\_110/20KV].

- Deri në miratimin e Metodologjisë së përcaktimit të cmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar, teprica e energjisë, që tejkalon konsumin mujor, do t'i kalojë furnizuesit të shërbimit universal pa kundërshpërblim për vetëprodhuesit.

## **2. Baza Ligjore e Akt-Marreveshjes**

- Udhezim nr 3 dt 20.06.2019 MIE
- Ligji Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike “
- .Ligji nr125/2013 “Per koncesionet dhe partneritetin public privat indryshuar edhe ne VKM nr 576 dt 10.07.2013 “Per miratimin e rregullave per identifikimin, vleresimin dhe dhenien e koncesioneve per hidrocentralet”
- Vendimi Nr.100, date 26.08.2008 i Bordit te Komisionereve te ERE-s “Kodi i Shperndarjes se Energjise Elektrike”
- “Rregullore për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166 date 10.10.2016, i ndryshuar, te Bordit te Komisionereve te ERE.
- Ligjit të energjisë të burimeve të rinovueshme 7/2017
- Kodi i Shperndarjes
- Kodi i Matjes

## **3. Kushtet e aplikueshme**

Kjo Marrëveshje (përfshin të gjitha Anekset) përcakton Kushtet e Përgjithshme të OSSH sh.a për Lidhjen e Impianteve PV te veteprodhuesve me Sistemin e Shpërndarjes se energjise elektrike.

## **4. Marrëveshja për lidhjen**

- 4.1 Në varësi të afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje, OSSH sh.a bie dakord të lidhë impiantin PV per veteprodhim i cili dote punoje ne paralel me Sistemin e Shpërndarjes dhe impianti PV do te vendoset ne pune i lidhur me rrjetin e shperndarjes nga data e lidhjes së objektit me afat kohor te pa përcaktuar.
- 4.2 Përpara fillimit te punimeve per realizimin e lidhjes se re lidhjes, Klienti duhet të paguajë çdo tarifë të përcaktuar në lidhje me ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje dhe te jete i pajisur me lejen e punimeve nga institucionet perkatese.

## **5. Tarifat**

- 5.1 Klienti duhet t'i paguajë OSSH sh.a të gjitha tarifat e përcaktuara sipas kësaj Marrëveshje. Keto tarifa jane te draftuara dhe jane derguar per miratim ne ERE .
- 5.2 Të gjitha shumat e paguara nga Klienti në OSSH sh.a , sipas kësaj Marrëveshjeje, do të kryhen të plota dhe pa asnjë zbritje dhe pa shtyrje afati.

## **6. Përfaqësimet**

Të dyja palët përfaqësojnë dhe garantojnë njëra tjetrën vazhdimisht gjatë kohëzgjatjes së Akt - Marrëveshjes se ato kanë fuqi dhe autoritet të plotë për të lidhur dhe zbatuar këtë marrëveshje. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të bjerë ndesh, nuk do të shkelë ose nuk do të dëmtojë asnjë kontratë, marrëveshje, gjykim, statut, urdhëresë ose rregullore që mund të jenë detyruese për njërën nga Palët.

## **7. Ndryshimet**

- 7.1 Pas miratimit të rregullave teknike procedurave, tarifave dhe propozimeve për ndryshim të Kodit të Shpërndarjes dhe Kodit të matjes nga ERE si detyrime që përcaktohen në udhëzimin e MIE nr.3 datë 20.06.2019 kjo marrëveshje do të jetë subjekt i rishikimit sipas kriterëve të miratuara për impiantet PV për veteprodhim sipas skemës së matjes neto.  
Asnjë ndryshim i kësaj marrëveshjeje nuk do të jetë efektiv nëse nuk bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.
- 7.2 Secila palë mund të lajmërojë në çdo kohë Palën tjetër për të propozuar se kjo Marrëveshje duhet të ndryshohet.
- 7.3 Nëse ndryshimi i propozuar sipas kësaj dispozite nuk pranohet nga palët brenda (1) një muaji nga data e propozimit, secila Palë mund t'ia dërgojë ERE-s çështjen për zgjidhje. Palët do të jenë të detyruara të pranojnë vendimin e ERE's dhe ta vënë në zbatim. Dhe, nëse është e mundur, ato mund të lidhin një marrëveshje plotësuese që mund t'i bashkëngjitet kësaj Marrëveshje.

## **8. E drejta e shfrytëzimit**

- 8.1 Klienti do t'i paguajë me shpenzimet e veta OSSH sh.a të gjitha Miratimet për të cilat ka marrë aprovimin e OSSH sh.a për sa i përket instalimit, operimit, riparimit, mirëmbajtjes, inspektimit dhe çmontimit të pajisjeve të OSSH sh.a të cilat janë të vendosura në tokën ose ndërtesën nën pronësinë dhe nën kontrollin e klientit. Cdo miratim i tillë do të lejohet sipas afateve dhe kushteve që janë të pranueshme nga OSSH sh.a, duke patur parasysh afatet dhe kushtet sipas të cilave miratime të ngjashme dhe të përparshme janë lejuar nga OSSH sh.a.
- 8.2 Klienti do të lejojë punonjësit, nën-kontraktorët, agjentët, ose konsulentët e OSSH sh.a në periudhat kur është rënë dakord nga Palët – edhe gjatë afatit edhe pas përfundimit të kësaj marrëveshjeje – të hyjnë në ato pjesë të ambjentëve të Klientit me qëllim që të kryejnë punime për lidhje ose për modifikime apo për të operuar, lexuar matësat, inspektuar, testuar pajisjet e matjes, punuar me pajisjet e OSSH sh.a ose të objektit, për të shkëputur Pikën e Lidhjes ose për t'i mundësuar OSSH sh.a të përmbushë detyrimet e veta sipas kushteve dhe afateve të kësaj Marrëveshjeje. OSSH sh.a do t'i jepet akses i sigurt dhe i papenguar. Këto të drejta janë të nevojshme për të kryer funksionet në bazë të të cilave është dhënë e drejta e aksesit. Të gjitha të drejtat do të ushtrohen pa asnjë tarifë. Punonjësit e OSSH sh.a do të përpiqen maksimalisht për të bashkëpunuar me klientin gjatë kohës punojnë në ambientet e klientit.

## **9. Punimet për lidhjen**

- 9.1 Te gjitha punimet për realizimin e lidhjes me rrjetin shpërndaresh do të kryhen nga Klienti me

shpenzimet e tij.

- 9.2 Klienti do të kryejë punimet për lidhjen e tij në përputhje me letrën e "Propozimit për Lidhjen e re" dhe do të marrë ato miratime që janë të nevojshme për të për këtë qëllim me shpenzimet e veta.(leje punimesh; miratime të ndryshme, etc)
- 9.3 Verifikimet e rregullshmerise se kryerjes se punimeve dhe instalimeve janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.
- 9.4 Klienti do të njoftojë paraprakisht OSSH sh.a kur ai do të jetë gati për kryerjen e verifikimeve dhe testeve.
- 9.5 Klienti nuk do të lidhet në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike nëse nuk është kryer verifikimi dhe kontrollin e punimeve për ndërtimin e impiantit PV për veteprodhim dhe pajisjeve elektrike të instaluar për këtë qëllim.

## **10. Kufizimi i kërkesës për energji elektrike**

- 10.1 Fuqia e instaluar e impiantit PV për prodhimin e energjisë elektrike nga dielli, nuk duhet të kalojë fuqinë e kërkuar të lidhur në kontratën e furnizimit me energji elektrike.
- 10.2 Nëse fuqia maksimale e kërkuar tejkalohet atëherë Klienti duhet të aplikojë për shtesë fuqie sipas rregullave dhe tarifave në fuqi. Vetëm pas të kësaj kryer shtesën e fuqisë klienti do të aplikojë perseri për shtesë fuqie të impiantit PV.
- 10.3 OSSH mund të shpëtojë impiantin për vetekonsum, në rast kur vërtetohet se klientet kanë projektuar një impiant i cili në harkun e një viti tejkalon konsumin e energjisë të klientit ose kur vërtetohet se impianti është instaluar dhe/ose funksionon ndryshe nga projekti i miratuar.

## **11. Faktori i fuqisë**

- 11.1 Impianti FV-SNM në kushte normale duhet të operojë me faktor të fuqie të barabartë me 1 ose të paktën me një faktor fuqie më të madh se 0.98.
- 11.2 Inverterat smart të këtyre njësive duhet të bëjnë rregullimin automatik në mënyrë të tillë që faktori i fuqisë të mos sjellë ndryshime të niveleve të tensionit përtej limiteve të lejuara.

## **12. Pajisjet e matjes**

12.1 Subjekti është i detyruar, sipas nenit 15 "Skemat e matjes neto të energjisë, të ligjit nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë", të instalojë me shpenzimet e veta një matës inteligjent me dy drejtime, sipas kërkesave të përcaktuara nga OSSH në përputhje me Kodin e Matjes. Matesi, duhet të matë energjinë elektrike që subjekti merr nga rrjeti i OSSH dhe energjinë elektrike që subjekti (impjanti PV) fut në rrjetin e OSSH. Për të njohur konsumin e përgjithshëm të energjisë elektrike të klientit veteprodhues, vendoset një matës inteligjent me një drejtim të prodhimit pas inverterit kryesor, sipas kërkesave të përcaktuara nga OSSH në përputhje me Kodin e Matjes.

12.2 Matësat duhet të jenë të aftë që të komunikojnë në distancë. Matësat duhet të jenë të pajisur me modem të integruar për komunikim. Matësi duhet të ofrojë mundësinë e ndërrimit të modulit të komunikimit pa prishur vulat e matësit (vulat e makinerisë), dhe pa ndërprerë energjinë e matësit.

Matësi duhet të ketë të paktën një portë seriale RS485 për komunikim me modem të jashtëm. Moduli i komunikimit duhet të regjistrojë alarme në matës nëse ndërhyhet në të dhe matësi duhet të shkëpusë konsumatorin nga energjia.

Matësi duhet të ketë aftësitë e mëposhtme të komunikimit :

- Optik / IEC62056-21
- Duhet të ketë të paktën një RS485/IEC62056-21 or ISO/IEC14098.

12.3 Klienti nuk do të ndërhyjë apo lejojë ndonjë interferencë tek Pajisjet e Matjes dhe do të dëmshpërblejë OSSH sh.a në rast të ndonjë ndërhyrjeje.

12.4 Në rast se njëra nga Palët ka motive për të besuar se Pajisjet e Matjes operojnë jashtë klasit të gabimit të lejuar atëherë ajo njofton menjëherë Palën tjetër. Në këtë mënyrë, Pajisjet Matëse do të kontrollohen nga Laborator i certifikuar i panvarur. Nëse gjatë testimit të Pajisjeve të Matjes:

- a) Rezulton që Pajisjet e Matjes operojnë jashtë klasit të gabimit të lejuar, ato do të ri-kolaudohen ose zëvendësohen

### 13. Testimi dhe Kolaudimi

Testimi dhe komisionimi i impianteve FV-SNM do të bëhet në prani të operatorit të shpërndarjes. Aplikanti duhet të njoftojë me shkresë 28 dite përpara përfundimit të instalimit operatorin e shpërndarjes paraprakisht me një plan testimi dhe komisionimi të detajuar. Aplikuesi duhet të mbajë dokumentacionin mbi rezultatet e testimit dhe parametrat e mbrojtjes.

Gjatë fazës së testimit do të kërkohen 2 lloje testesh :

#### 1. Testet e përputhshmërisë së parametrave në inverter

- Aplikuesi është përgjegjës për të vërtetuar që inverteri (inverterat) dhe parametrat e tij janë në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.
- Rezultatet e certifikuara të testeve duhet të dorëzohen për verifikim.

#### 2. Testet e pajtueshmërisë me rregullat e lidhjeve të brendshme dhe lidhjes me rrjetin lokal të shpërndarjes

- Para fazes së komisionimit, duhet të sigurohet që skema e lidhjes sipas skemes së aprovuar, që instalimet janë në përputhje me standartin dhe skemen e miratuar, tarimet janë vendosur sipas kufijve të vendosur në rregulloret etj.
- Lidhja e sistemit të impiantit FV indirekt nuk duhet të ketë sjelle pasoja të dëmshme në funksionimin e rrjetit shpërndarës sipas kërkesave të Licencës së Shpërndarjes.

- B. Në procesin e komisionimit duhet të kryhen testet e mëposhtme:
1. Mbrojtja e mos punimit në ishull,
  2. Skemat e nderlidhjes së mbrojtjeve impiant-rrjet shpërndares (nëse ka)
  3. Testet funksionale të pajisjeve
  4. Matjet e parametrave të Cilësisë së Energjise

Gjate procesit të komisionimit të impiantit FV duhet të merren të gjitha masat e nevojshme që të shmangen ndikimet e dëmshme në funksionimin e rrjetit të Shpërndarjes.

Testimet e komisionimit të instalimeve FV duhet të kryhen nga inxhinier të çertifikuar autorizuar nga aplikuesi SMN .

Të gjitha testet duhet të kryhen nga testues të kualifikuar.

Pajisjet e testimit duhet të kenë certifikatë të vlefshme të kalibrimit.

#### **14. OPERIMI DHE MIRËMBAJTJA**

Aplikuesi gjithashtu duhet të sigurojë OSSH me një deklaratë që përcakton se ai është i vetëdijshëm për nevojat Operim dhe Mirëmbajtjes të impiantit FV, duke treguar se kush do të jetë përgjegjës për Operimin dhe Mirëmbajtjen.

Aplikuesi / zotëruesi i Impiantit FV-SNM është përgjegjës për mirëmbajtjen e këtij impianti.

Mirëmbajtja e rrjetit të shpërndarjes deri në piken e lidhjes dhe e matësit të energjisë neto është nën përgjegjësinë e plotë të operatorit të shpërndarjes.

Çdo keqfunksionim i impiantit FV-SNM deri në piken e lidhjes duhet të riparohet dhe të normalizohet nga Aplikuesi/zotëruesi i impiantit FV.

Në rast të konstatimit të shpërndarjes së energjisë nga rrjeti i shpërndarjes , zotëruesi i Impiantit FV-SNM duhet të sigurojë që në asnjë mënyrë të mos ketë kalim të energjisë elektrike nga rrjeti i tij i brendshëm drejt rrjetit lokal të shpërndarjesku ai është i lidhur.

Zotëruesi i impiantit FV-SNM është i vetmi përgjegjës për çdo aksident / incident ndaj qenieve njerëzore dhe pajisjeve që mund të ndodhin për shkak të kalimit të energjisë drejt rrjetit të shpërndarjes nga çdo burim i brendshëm gjenerimi i mundshëm i tij kur konstatohet mos prezencë tensioni nga rrjeti elektrik i shpërndarjes.

Operatori i shpërndarjes rezervon të drejtën për të shkëputur lidhjen me rrjetin e shpërndarjes me Konsumatorin në çdo kohë në rast të mospagimit siç është specifikuar në kontratën e energjise, dëmtimin e rrjetit të shpërndarjes, matësit etj, ose për të parandaluar aksidentin ose dëmtimin.

Në rastet që nivelet e tensionit do të kalojnë kufijtë e lejuar ose të cenohet siguria e rrjetit të OSSH shihet do të ketë kufizime prodhimin deri në shpërndarje sa herë të lindë nevojshme

#### **15. Perspektiva e zhvillimit të rrjetit shpërndares**

OSSH sh.a do të zhvillojë vazhdimisht rrjetin e shpërndarjes dhe zgjidhja afatgjate parashikon zëvendësimin e rrjetave 6;10 dhe 35 kV me rrjeta me tension 20 kV. Nëse asetet e lidhjes suaj i përkasin një niveli tjetër tensioni (6; 10 ose 35kV) dhe zhvillimi i ardhshëm kërkon zëvendësimin e tyre me një rrjet 20kV, atëherë ju do të mbartni përgjegjësinë dhe detyrimin e të gjitha shpenzimet për zëvendësimin e pajisjeve me qëllim që ato të përshtaten me nivelin e ri të tensionit.

**16. Marrëveshja e plotë**

Kjo Marrëveshje (së bashku me të gjitha dokumentet bashkëngjitur) përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet Palëve për sa i përket subjektit të saj.

Kjo Marrëveshje zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme ndërmjet Palëve për sa i përket subjektit të saj.

Secila Palë pranon dhe konfirmon se nuk ajo e nënshkruan këtë marrëveshje në besueshmëri të një përfaqësimi, garancie apo sipërmarrje tjetër nga Pala tjetër, nëse nuk reflektohen plotësisht në këtë Marrëveshje.

**17. Ligji i aplikuar**

Marrëveshja do të interpretohet, shpjegohet dhe administrohet nga ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe të dyja Palët do t'i nënshtrohen juridiksionit ekskluziv të gjykatave shqiptare.

**18. Zgjidhja e konflikteve**

Nëse deklarohet shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje dhe në kundërshtim me kërkesat ligjore, për çdo konflikt ose mospajtim që lidhet me këtë Marrëveshje, Palët do t'i drejtohen ERE-s.

Nën praninë e secilës prej palëve, personat e autorizuar të Palëve nënshkruajnë për sa përshkrua më sipër këtë Marrëveshje .

**Me konsiderate**

**Klienti**

**Blendian DALIPI**  
**ADMINISTRATOR**  
**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A.**



**MC Donalds**

Nr. Prot. 3037/  
3

Tiranë, më 4 / 5 / 2023

**Drejtuar:** MC Donalds

Elbasan

**Lënda: LEJE PËR FILLIMIN E PUNIMEVE PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT**

I nderuar,

Duke iu falenderuar për përgatitjen e projektit ndërtimor dhe elektrik të lidhjes së impiantit fotovoltaik vetëprodhues, ne konfirmojmë se projekti i paraqitur është në përputhje me Standartet dhe Specifikimet Teknike të kërkuara nga OSSH sha.

Për sa më sipër, ne iu lejojmë që të filloni punimet për zbatimin e projektit ndërtimor dhe elektrik të impiantit fotovoltaik vetëprodhues bazuar në aplikimit tuaj ,miratimin për lidhjen me rrjetin e shperndarjes dhe Akt – Marrëveshjen.

Pas lejimit për fillimin e punimeve dhe në përputhje me termat që kemi rënë dakort sipas dokumentave të mësipërm ju jeni të lutur të na njoftoni paraprakisht për përfundimin e punimeve duke paraqitur aktkollaudimin dhe vetëdeklarimin referuar udhezimit nr 3 te MIE dt 20.06.2019.

Vendosja e pajisjeve nën tension nuk do të kryhet nëse nuk do të realizohen paraprakisht Akt – Kontrolllet e percaktuara me sipër.

**Blendian DALIPI**  
Administrator

OSSH sh.a

